

# RAPORTI VJETOR PËR KRIMET NGA URREJTJA

NË VITIN  
2015

KRIMET NGA  
URREJTJA



Përmbajtja e këtij publikimi nuk i përfaqëson gjithmonë këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup. Misioni i përmbahet vendimit PC.DEC/81 të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së



Organization for Security and  
Co-operation in Europe  
**OSCE Mission to Skopje**

**Botues:**

KHM përfaqësuar nga presidenti prof. dr. Gordan Kalajxhiev

**Redaktor:**

Uranija Pirovska

**Autorë:**

Voislav Stojanovski, dr.

Pavle Bogoevski

Sanja Barlakovska

KOMITETI I  
**HELSEINKIT**  
PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
I REPUBLIKES SE  
**MAQEDONSE**

Naum Naumovski Borçe 83  
1000, Shkup  
Tel: +389 (0)2 3119 073  
Faks: +389 (0)2 3290 469  
Web: [www.mhc.org.mk](http://www.mhc.org.mk)  
E-mail: [helkom@mhc.org.mk](mailto:helkom@mhc.org.mk)

# PËRMBAJTJA

<b>1. PËR PROJEKTIN</b> .....	<b>50</b>
<b>2. METODOLOGJIA</b> .....	<b>51</b>
2.1 Monitorimi i mediave kombëtare të shtypura dhe elektronike .....	51
2.2 Ofrimi i ndihmës ligjore pa pagesë për viktimat .....	51
2.3 Monitorimi i rasteve gjyqësore të krimeve nga urrejtja .....	51
2.4 Raportimi i krimeve nga urrejtja dhe incidenteve nga urrejtja tek Misioni i OSBE-së në Shkup .....	52
2.5 Mirëmbajtja e një ueb-faqeje interaktive për raportimin e krimeve nga urrejtja ....	52
2.6 Sigurimi i informatave dhe burimeve për organizatat e tjera qytetare .....	52
2.7 Pjesëmarrja në trajnime dhe ngjarje të organizuara nga OSBE/ODIHR .....	52
<b>3. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE</b> .....	<b>53</b>
3.1 Konteksti .....	53
3.2 Numri i incidenteve .....	53
3.3 Llojet e krimeve .....	54
3.4 Incidente sipas lokacionit .....	55
3.5 Incidentet sipas muajve .....	55
3.6 Incidentet sipas motiveve me paragjykim .....	56
3.7 Viktimat dhe autorët e krimit .....	56
3.8 Statusi i rasteve .....	57
<b>4. AKTIVITETET E EKIPIT TË PROJEKTIT</b> .....	<b>58</b>
4.1 Monitorimi i mediave të shtypura dhe elektronike .....	58
4.2 Ofrimi i ndihmës ligjore pa pagesë për viktimat .....	58
4.3 Monitorimi i rasteve gjyqësore mbi krimet nga urrejtja dhe përgjigjeve nga gjyqësori.....	59
4.4 Raportimi i krimeve nga urrejtja dhe incidenteve nga urrejtja tek OSBE/ODIHR ....	62
4.5 Mirëmbajtja e një ueb-faqe interaktive për raportimin e krimeve nga urrejtja .....	62
4.6 Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë qytetare në ngritjen e vetëdijes .....	63
4.7 Ngritja e vetëdijes në shkolla të mesme ku janë regjistruar incidente nga urrejtja	63
4.8 Grupi punues për ndryshime në legjislacion për krimet nga urrejtja .....	63
4.9 Shënimi i 22 korrikut- Ditës Evropiane të Viktimave nga Krimet e Urrejtjes .....	64
<b>5. PËRFUNDIMET</b> .....	<b>64</b>
<b>6. REKOMANDIME</b> .....	<b>65</b>
<b>SHTOJCË</b> .....	<b>66</b>
Incidentet nga krimet e urrejtjes në 2015 .....	66

# 1. PËR PROJEKTIN

Ky raport është rezultat i projektit për “Përforcimin e kapacitetit kombëtar për të trajtuar krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes” i cili u mbështet financiarisht nga Misioni i OSBE-së në Shkup dhe është realizuar në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit 2015. Qëllimi kryesor i Projektit është të zmadhojë kuptimin dhe të përforcojë kapacitetin e aktorëve institucionalë dhe të shoqërisë civile për t’u ballafaquar në mënyrë efikase me krimin nga urrejtja dhe gjuhën e urrejtjes në pajtim me legjislacionin vendor, përkushtimet e OSBE-së dhe Standardet ndërkombëtare. Njëri nga qëllimet kryesore të projektit është të zmadhojë kapacitetin e praktikuesve ligjor dhe shoqërisë civile dhe të raportojë dukuritë e krimeve të urrejtjes në vend. Ky raport është paraparë që të shërbejë si tregues i shtrirjes, natyrës dhe shpeshtësisë së krimeve nga urrejtja në vend.

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (KHM) veproi si partner zbatues dhe realizoi aktivitetet në vijim që lidhen me krimet nga urrejtja:

1. Monitorimi i vazhdueshëm i incidenteve/krimeve nga urrejtja me fokus të veçantë mbi dhunën në sport me motivim të njëanshëm;
2. Ofrimi i ndihmës ligjore pa pagesë për viktimat nga krimet nga urrejtja;
3. Monitorimi i rasteve gjyqësore dhe reagimit të gjyqësorit në raste të caktuara të krimeve nga urrejtja për karakteristikat e ndryshme të mbrojtura;
4. Rishikimi i rasteve të raportuara të urrejtjes dhe kontribut për Raportin vjetor të ODIHR-it mbi krimet nga urrejtja dhe incidentet në rajonin e OSBE-së
5. Mirëmbajtja, përditësimi dhe përkthimi i ueb-faqes [www.zlostorstvaodomraza.mk](http://www.zlostorstvaodomraza.mk);
6. Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile për ngritjen e vetëdijes ndaj konceptit të krimeve nga urrejtja;
7. Ndërmarrja e aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes në shkollat e mesme ku janë regjistruar incidente të urrejtjes;
8. Pjesëmarrja në Grupin punues për ndryshime të legjislacionit mbi krimet nga urrejtja; dhe
9. Është shënuar dita e propozuar Dita e viktimave të krimeve nga urrejtja

## 2. METODOLOGJIA

### 2.1 Monitorimi i mediave kombëtare të shtypura dhe elektronike

KHM është parapaguar në një numër gazetash ditore me prirje të ndryshme ideologjike dhe përkatësi të ndryshme politike. Monitorimi i mediave elektronike është bërë në bazë ditore, nëpërmjet dy gjeneratorëve më të njohur të lajmeve nga interneti ([www.time.mk](http://www.time.mk) dhe [www.grid.mk](http://www.grid.mk)), si dhe duke përdorur opsionet për kërkim të avancuar nën seksionin “Lajme” të [www.google.com](http://www.google.com). Posa është shënuar një krim nga urrejtja apo incident, KHM-ja ka shënuar titullin e lajmit dhe linkun e internetit dhe e ka botuar tek portali i internetit për raportimin e krimeve nga urrejtja -[www.zlostorstvaodomraza.mk](http://www.zlostorstvaodomraza.mk). Qëllimi kryesor i monitorimit të mediave ka qenë të identifikojë ngjarje të mundshme të incidenteve nga urrejtja dhe të kontaktojë viktimat e supozuara për intervistë dhe t'u ofrojë ndihmë ligjore pa pagesë apo monitorim të procesit gjyqësor të rastit të tyre.

### 2.2 Ofrimi i ndihmës ligjore pa pagesë për viktimat

Kurdo që një viktimë e supozuar është identifikuar dhe kontaktuar, KHM-ja ka ofruar shërbimet e veta për ndihmë ligjore pa pagesë. Janë organizuar takime me viktimën dhe familjen e tij/saj. Takimet janë realizuar ose në zyrat e KHM-së ose në ndonjë lokacion të propozuar nga viktimat. Gjatë takimit është realizuar edhe një intervistë. Në rastet në të cilat është supozuar se ka pasur incident/krim, është marrë deklaratë me shkrim, ndërsa nga viktimat është kërkuar të plotësojnë një Kërkesë standarde për ndihmë ligjore pa pagesë. Përveç kësaj, nga viktimat gjithashtu është kërkuar që të bashkëngjisin kopje të dokumenteve përkatëse për rastin e tyre. Viktimava u është dhënë mbështetje në formë të inkurajimit të tyre, duke i shoqëruar ata deri te stacioni policor, duke gjetur avokat mbrojtës i cili do t'i përfaqësonte ata pa kompensim në të holla, duke shkruar kallëzim penal, duke komunikuar me avokatë të cilët tashmë punojnë mbi raste dhe duke shkruar shkresa në emër të tyre. Gjithashtu, është ofruar mbikëqyrja e rastit para dhe pas procesit gjyqësor.

### 2.3 Monitorimi i rasteve gjyqësore të krimeve nga urrejtja

Monitorimi i procesit nga KHM fillon: 1) pas një kërkesë formale për ndihmë ligjore pa pagesë të dorëzuar në KHM nga personi në procedurën penale në lidhje me krimet nga urrejtja dhe 2) pas informatës së marrë nga gjykatat në lidhje me procedurat gjyqësore të caktuara dhe gjykimit në vijim në lidhje me krimet nga urrejtja. Para se të fillojë mbikëqyrësi i KHM-së të realizojë mbikëqyrjen e procesit gjyqësor, që vijon pas kërkesës formale, personit i cili ka dorëzuar kërkesën i kërkohet që të sigurojë dokumentacionin e plotë në lidhje me rastin e tij/saj (d.m.th. fotokopje të të gjitha dokumenteve ligjore të marra gjatë procedurave gjyqësore të vendit apo institucioneve të tjera). Pasi janë marrë dokumentet, është caktuar një këshillues ligjor për rastin dhe i është dhënë detyra për të analizuar dhe përcaktuar veprimet e mëtejshme të cilat duhet të ndërmerren para, gjatë dhe pas procesit gjyqësor. Këshilluesi gjyqësor më pas ka përgatitur raportet të cilat i referohen gjithë procedurës dhe ka elaboruar për atë se a është kryer procesi në pajtim me normat ligjore. Monitorimi i proceseve gjyqësore i dha mundësi ekipit të projektit për të vlerësuar mënyrën në të cilën janë të trajtuar viktimat në procesin gjyqësor.

## 2.4 Raportimi i krimeve nga urrejtja dhe incidenteve nga urrejtja tek Misioni i OSBE-së në Shkup

Hollësitë në lidhje me incidentet, siç janë përshkrimi i shkurtër, data, koha, lokacioni, burimi i informatave, viktimat) e përfshira, autorët e krimit, statusi i rastit, përgjigja nga autoritetet dhe ndikimi tek viktimat) dhe bashkësia, janë raportuar rregullisht tek Misioni i OSBE -së në Shkup. Raportimi mbi krimet nga urrejtja dhe incidentet është lehtësuar nga krijimi i një ueb-platforme për të bërë rrjetin e krimeve. Krahas asaj që mund të ndiqen incidentet e krimeve nga urrejtja onlajn pasi që të ndodhin, Misionit të OSBE-së në Shkup i është dërguar një raport në ndërkohë dhe një raport final të përgatitur nga KHM. Ky raport final do të ndahet me ODIHR për raportin e tyre vjetor për krimet nga urrejtja në vendet anëtare të OSBE-së.

## 2.5 Mirëmbajtja e një ueb-faqeje interaktive për raportimin e krimeve nga urrejtja

UEB-portali - [www.zlostorstvaodomraza.mk](http://www.zlostorstvaodomraza.mk) është një vegël interaktive që u mundëson qytetarëve të marini informata dhe të raportojë për krimet nga urrejtja. Përmban një hartë interaktive që tregon se ku da se përfli po gjendet gjendet lokacioni i incidenteve. Faqja kryesore radhit kategoritë e krimeve nga urrejtja dhe motivet anësore, jep informata në lidhje me mënyrën se si mund të raportojnë qytetarët (e-aplikacionet, twitter, email dhe formën onlajn) dhe paraqet grafikët statistikorë. Në ueb-portal gjenden gjithashtu seksionet me Pyetjet me të shpeshta, Burimet dhe Fjalorin, ku janë dhëna informata në lidhje me projektin, kuptimin dhe shtrirjen e krimeve nga urrejtja dhe botimeve në lidhje me këto krime. Krahas gjuhës maqedonase, portali është gjithashtu edhe në gjuhën angleze dhe shqipe.

## 2.6 Sigurimi i informatave dhe burimeve për organizatat e tjera qytetare

KHM organizoi një konferencë për shtyp për të prezantuar Analizat e veçanta për krimet nga urrejtja në vend për vitin 2014, në korrik të vitit 2015.<sup>1</sup> Ftesa për konferencën për shtyp është dërguar tek mbi 50 organizata joqeveritare. Një numër i përfaqësuesve të OJQ-ve dhe institucioneve shtetërore morën pjesë në konferencë dhe u informuan për mundësinë për të përdorur KHM-në si qendër për burime mbi krimet nga urrejtja. KHM, Metamorphosis, Forumi Rinor dhe Instituti Maqedonas për Media (organizata qytetare lokale) po punojnë së bashku mbi tema që përfshijnë krimet nga urrejtja dhe gjuhën e urrejtjes. Përveç kësaj, KHM -ja ka hapur një faqe për vetëdijësim për krimet nga urrejtja në Facebook (<http://goo.gl/8yY5Lk>), një faqe në Twitter (<https://twitter.com/HateCrimesMK>) dhe ka futur një seksion të veçantë mbi krimet nga urrejtja në raportet e veta mujore mbi situatën me të drejtat e njeriut në vend të cilat janë të shpërndara tek institucionet shtetërore, mediat, organizatat joqeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat e huaja në vend.

## 2.7 Pjesëmarrja në trajnime dhe ngjarje të organizuara nga OSBE/ODIHR

Me qëllim avancimin e mëtutjeshëm të njohurisë institucionale për krimet nga urrejtja, anëtarët e ekipit të projektit morën pjesë në një numër të madh trajnimesh dhe ngjarjesh të organizuara nga OSBE/ODIHR në vend dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor (Serbi, Kroaci dhe Mal të Zi). Krahas pjesëmarrjes në trajnime dhe ngjarje të organizuara nga OSBE-ja, anëtarët e ekipit të projektit morën pjesë në dy ngjarje profesionale që kanë të bëjnë me krimet nga urrejtja në Gjermani.

1) Në dispozicion në: <http://www.mhc.org.mk/analysis/309>

## 3. PËRMBLEDHJE E


# GJETJEVE KRYESORE

### 3.1 Konteksti

Krimet nga urrejtja në Rajonin e OSBE-së - Incidente dhe Përgjigje: Raporti vjetor për vitin 2012 shënon se në periudhën midis 2008-2012 “51 Shtete pjesëmarrëse kanë informuar ODIHR-në se kanë grumbulluar disa të dhëna mbi krimet nga urrejtja. Ish Republika Jugosllave të Maqedonisë ka deklaruar se nuk grumbullon kurrfarë statistikash të këtij lloji.”<sup>2</sup> Portali i internetit për raportimin e krimeve nga urrejtja i ODIHR-it 2014 shënon se “ODIHR ka vërejtur se Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë nuk grumbullon të dhëna dhe statistikë për krimet nga urrejtja.”<sup>3</sup> Në “Raportin e progresit të Komisionit Evropian 2015 për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” thuhet se “grumbullimi i të dhënave mbi raportimin, hulumtimin dhe përndjekjen e (...) krimeve nga urrejtja nuk është ende sistematik.”<sup>4</sup> Në vitin 2014, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut botoi një analizë të veçantë mbi krimet nga urrejtja të regjistruara në 2013.<sup>5</sup> Kjo analizë, së bashku me Raportin vjetor për krimet nga urrejtja në 2014,<sup>6</sup> ky raport dhe ueb-portalin për raportimin e krimeve nga urrejtja - [www.zlostorstvaodomraza.com](http://www.zlostorstvaodomraza.com), përfaqësojnë përpjekjet e para konkrete për të hartëzuar, monitoruar dhe raportuar mbi incidentet e krimeve nga urrejtja në vend.

### 3.2 Numri i incidenteve

Gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2015, janë regjistruar gjithsej 44 krime nga urrejtja dhe incidente. Shumica e incidenteve janë raportuar njëherë nga mediat apo Ministria e Punëve të Brendshme,



përderisa 4 prej tyre janë raportuar nga vëzhguesit e KHM-së. 31 incidente janë verifikuar me anë të kontaktit me policinë, buletinet e policisë, raportimi i mediave dhe takime me viktimat. 13 nga incidentet e regjistruara nuk janë verifikuar, por sidoqoftë janë përfshirë në raport për shkak të ekzistimit të treguesve anësorë duke përfshirë këtu edhe: perceptcionin viktimë/dëshmitarë; Komentet e bëra në vendin e ngjarjes; Dallimin midis viktimës dhe kryerësit

të veprës mbi baza etnike; Modelin/shpeshtësinë e incidenteve të mëparshme; *Natyren e dhunës*; Mungesën e motiveve të tjera; dhe lokacioni dhe kohën (tajmingu). Më saktësisht, incidentet e pa-

2) OSBE/ODIHR, Krimet nga urrejtja në Rajonin e OSBE-së - Incidente dhe Përgjigje: Raporti vjetor për vitin 2012, Varshavë, nëntor 2013, f. 16-17. Gjetendet: [http://tandis.odihhr.pl/hcr2012/pdf/Hate\\_Crime\\_Report\\_full\\_version.pdf](http://tandis.odihhr.pl/hcr2012/pdf/Hate_Crime_Report_full_version.pdf)

3) Në Gjetendet në: <http://hatecrime.osce.org/former-yugoslav-republic-macedonia> (shih vërejtjet kryesore të ODIHR).

4) Komisioni Evropian, “Raporti i progresit për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë 2015, Bruksel, 10 nëntor 2015”, f.21.

5) Në dispozicion në: <http://www.mhc.org.mk/analysis/209>

6) Në dispozicion në: <http://www.mhc.org.mk/publications/309>


verifikuara janë përfshirë për shkak të informatës së marrë në lidhje me lokacionin e incidentit (p. sh. lagjet dhe shkollat etnikisht të përziera, linjat e autobusit të përdorura nga anëtarë të bashkësive të ndryshme etnike, vendet ku kanë ngjarë krime nga urrejtja në të kaluarën etj.), llojin e incidenteve (p. sh. një grup më i madh i të rinjve sulmojnë një apo më shumë viktime pa provokime, përlëshje të grupeve, sulme në një autobus apo një stacion autobusi etj.), kohën e incidentit (duke pasuar ndonjë përlëshje të mëhershme si një formë hakmarrjeje, pas orarit shkollor, gjatë apo pas ndonjë ngjarjeje sportive etj.) dhe pronën e dëmtuar gjatë incidentit (p. sh. vende për adhurim fetar). Raportet e paverifikuara dhe ato të verifikuara mund të shihen veç e veç në ueb-portalin për raportim të krimeve nga urrejtja. Në Aneksin e këtij raporti, incidentet e verifikuara dhe të paverifikuara janë theksuar me një shënim në kllapa që vijon pas titullit të incidentit.

Në krahasim me incidentet e regjistruara në 2013 dhe 2014, ndryshimi më i madh ka të bëjë me viktimitën, shumica e të cilëve tani janë refugjatë apo emigrantë. Në fund të vitit 2014 dhe gjatë vitit 2015 vendi dëshmoi një numër të paparë të refugjatëve që po tranzitonin përmes vendit në përpjekje për të hyrë në zonën e Shengenit të BE-së. 21 nga 44 incidentet (48%) në 2015 kanë përfshirë sulmin apo plaçkitjen (duke përfshirë edhe vjedhje të armatosur) ndaj refugjatëve apo imigrantëve gjatë tranzitimit të tyre në vend. Gjatë këtyre incidenteve, së paku 62 (pothuajse 50% e gjitha viktimitave të regjistruara) sirianë, afganë, irakianë dhe marokenë kanë qenë viktime të krimeve nga urrejtja.

Një tjetër dallim i theksuar midis 2013/2014 në krahasim me 2015 është fakti se në 2015 nuk është regjistruar asnjë incident i vetëm si rezultat i orientimit seksual/identitetit gjinor të viktimit. Ky fakt nuk do të thotë medoemos se shoqëria është bërë më tolerante në lidhje me bashkësinë LGBT. Duhet të shënohet se në këtë moment se autoritetet e shtetit kanë dështuar në hetimin si duhet të incidenteve në 2013 dhe 2014, ndërsa policia ka dështuar në arrestimin e pjesës së madhe të shkelësve. Dështimi i shtetit për të vepruar në mbrojtje të viktimitave, refuzimi i Parlamentit për të përfshirë orientimin seksual si bazë mbi të cilën mund të ndodhin diskriminime dhe krime nga urrejtja dhe planet e Qeverisë për të përcaktuar martesën në mënyrë kushtetuese si një bashkësi vetëm midis burrit dhe gruas, ka pasur ndikim negativ tek njerëzit nga LGBT të cilët mund të jenë frikësuar për të raportuar krimet kundër tyre.

Dallimi i tretë i madh, por pozitiv, është dallimi tek numrat e incidenteve si rezultat i përkatësisë etnike maqedonase apo shqiptare të kryerësit/viktimit. Në vitin 2013, këto incidente përfshinin 84% nga të gjitha incidentet (98 nga 116), kurse në vitin 2014 përqindja ka qenë 61% (53 nga 87). Gjatë vitit 2015 vetëm 15 incidente (34%) kanë ndodhur midis maqedonasve dhe shqiptarëve.

### 3.3 Llojet e krimeve





Shumica e krimeve janë kryer nga të rinjtë dhe hajdutët. Viktimat dhe kryerësit e veprave janë zakonisht anëtarë të grupeve të ndryshme etnike (maqedonas dhe shqiptar), kurse shumë viktime janë të përkatësisë marokene, siriane, irakiane dhe afgane. Incidentet e regjistruara lidhen me shkelje të pretenduara të ligjit sipas përkrahimit në Kodin Penal të shtetit. Llojet më të shpeshta të krimeve të kryera përfshijnë: sulme (21), vjedhje, duke përfshirë këtu edhe



plaçkitje të armatosur (20), lëndime trupore, duke përfshirë dhe dëmtime të rënda trupore (17), dëmtime të pronës (6) dhe pjesëmarrje në përlëshje (2). Përveç kësaj, njëri nga incidentet bie nën pretendimin e shkeljes penale për nxitjen e urrejtjes, mosmarrëveshjes dhe mostolerancës në baza nacionale. Shumë shpesh veprat penale të kryera në një incident plotësojnë kriteret për dy apo më tepër shkelje penale dhe prej këtu del dhe numri më i madh i shkeljeve të cilat janë prezantuar si incidente në këtë nëntitull.


### 3.4 Incidente sipas lokacionit



Pjesa më e madhe e incidenteve (41%) kanë ndodhur në Shkup (komunat e Qendrës, Çairit, Gazi Babës dhe Aerodromit) dhe në zonën e saj metropolitane. Janë regjistruar 10 incidente në Gjevgjeli, 6 në Kumanovë 2 në Manastir dhe Negotinë dhe nga 1 incident në Tetovë, Gostivar, Koçani, Kriva Palankë, Kavadarë dhe Veles (të gjitha qytetet me rajonet e tyre qytetare).


Qytetet në të cilat ka ndodhur numri më i madh i incidenteve janë përgjatë Autostradës të Korridorit evropian X. Në Shkup, shumica e incidenteve përfshijnë sulme midis anëtarëve të përkatësive etnike maqedonase dhe shqiptare, kurse në qytetet e tjera shumica e incidenteve kanë ndodhur në afërsi të autostradës që përdoret nga refugjatët në rrugën e tyre për në Bashkimin Evropian.

### 3.5 Incidentet sipas muajve



Gushti ka qenë muaji në të cilin kanë ndodhur numri më i madh i incidenteve - 9 (20% nga të gjitha incidentet e vitit të kaluar) ndërsa në shkurt dhe tetor, është regjistruar vetëm një incident.



### 3.6 Incidentet sipas motiveve me paragjykim



Shumica e krimeve nga urrejtja ndodhin përshkak të statusit të refugjatis apo emigrantit të viktimës (48%) apo përkatësisë së ndryshme etnike të viktimës dhe kryerësit (43%). Pothuajse të gjitha këto incidente përfshijnë maqedonas dhe shqiptare etnike edhe si viktimë edhe si kryerës të krimeve dhe marokenë, sirianë, irakianë dhe afganë si viktimë. Përkatësia politike është (11%) nga të gjitha incidentet. Një incident përfshinte besimin fetar dhe një tjetër aftësitë e kufizuara si arsye.

### 3.7 Viktimat dhe autorët e krimit


Ka pasur minimum 125 viktimë dhe 174 autorë të krimeve nga urrejtja gjatë vitit. Gjithmonë kur mediat kanë dhënë numër të pacaktuar të autorëve të krimeve (p. sh. midis 10 dhe 15) në këtë raport është përdorur vlera më e vogël.



raport është përdorur vlera më e vogël. Kurdo që është raportuar që një “grup” autorësh të krimeve kanë kryer një krim nga urrejtja, vlera e përdorur për këtë raport ka qenë 3 persona. Numri më i madh i viktimave janë të rinj të gjinisë mashkullore. Viktimë më e re është 14-vjeçare. Në 34 nga 44 incidentet kryerësit e sulmeve kanë vepruar në grup. Shumica e viktimave janë refugjatë apo imigrantë (pothuajse 50% të të gjitha viktimave) dhe meshkuj të mitur me nënshtetësi maqedonase. Në shumicën e incidenteve që përfshijnë refugjatët apo imigrantët, mediat dhe policia nuk kanë dhënë hollësi në lidhje me nënshtetësinë e tyre. Që nga nëntori i v. 2015, asnjë refugjat i vetëm me prejardhje siriane, afgane apo irakiane (SIA) nuk është sulmuar apo plaçkitur. Kjo me siguri ka të bëjë me faktin se që nga ky muaj vetëm qytetarët SIA janë konsideruar refugjatë, ndërsa të gjithë nështetasit e tjerë të huaj që arrijnë nga Greqia janë konsideruar “emigrant ekonomik”. Refugjatëve SIA u është lejuar hyrja në Qendrën tranzitore për refugjatë në qytetin e Gjevgjeliës (vendkalim i përkohshëm kufitar me Greqinë) dhe janë transportuar me tren deri tek Qendra tranzitore për refugjatë në fshatin Tabanoc (vendkalim i përkohshëm me Serbinë). Qytetarëve që nuk janë SIA nuk u është lejuar hyrja në vend, por shumica (shumica e tyre marokenë) kanë kaluar nëpërmjet kalimeve jo legale

tore për refugjatë në fshatin Tabanoc (vendkalim i përkohshëm me Serbinë). Qytetarëve që nuk janë SIA nuk u është lejuar hyrja në vend, por shumica (shumica e tyre marokenë) kanë kaluar nëpërmjet kalimeve jo legale

### 3.8 Statusi i rasteve



Policia ka gjetur kryerësit e dyshimtë të minimum 25 nga 44 incidentet. Një minimum i 11 incidenteve të tjera janë raportuar në polici dhe janë nën hetime. Duke marrë parasysh se nuk ka bazë të të dhënave për krimet nga urrejtja, rastet e zgjedhura janë regjistruar duke kontaktuar me policinë, duke monitoruar mediat dhe duke qenë të informuar drejtpërsëdrejti nga ana e viktimave. Nuk ka pasur informata në lidhje me statusin e 8 rasteve të incidenteve. Nga 5 incidentet në të cilat motivi ka qenë për shkak të përkatësisë politike, 4 janë ende në hetim. Incidentet që janë ende duke u hetuar përfshijnë viktime të cilat janë ose anëtarë apo përkrahës të partive politike opozitare. Incidenti i vetëm me motiv politik në të cilin një kryerës i veprës është identifikuar përfshin një viktimë, anëtar të partisë politike në pushtet, VMRO-DPMNE. Kallëzime penale janë ngritur kundër kryerës it(ve) në lidhje me 14 incidente të regjistruara nga ana e policisë. Akuzë kundërvajtëse janë ngritur kundër 4 kryerësve të incidenteve. Në një incident janë ngritur si kallëzim penal ashtu edhe akuzë kundërvajtëse, përderisa për dy incidente tjera policia nuk ka pasur bazë për të ngritur akuzë.

Policia ka gjetur kryerësit e dyshimtë të minimum 25 nga 44 incidentet. Një minimum i 11 incidenteve të tjera janë raportuar në polici dhe janë nën hetime. Duke marrë parasysh se nuk ka bazë të të dhënave për krimet nga urrejtja, rastet e zgjedhura janë regjistruar duke kontaktuar me policinë, duke monitoruar mediat dhe duke qenë të informuar drejtpërsëdrejti nga ana e viktimave. Nuk ka pasur informata në lidhje me statusin e 8 rasteve të

## 4. AKTIVITETET E

### EKIPIT TË PROJEKTIT

#### 4.1 Monitorimi i mediave të shtypura dhe elektronike

KHM ka monitoruar një numër të gazetave ditore me prirje të ndryshme ideologjike dhe përkatësi të ndryshme politike. Monitorimi i mediave elektronike është bërë në bazë ditore, përmes dy gjeneratorëve më të njohur të lajmeve në internet ([www.time.mk](http://www.time.mk) dhe [www.daily.mk](http://www.daily.mk)), si dhe duke përdorur opsionet për kërkim të avansuar nën seksionin “News” të [www.google.com](http://www.google.com). Posa të jetë regjistruar ndonjë krim apo incident nga urrejtja, KHM e ka publikuar atë në portalin e internetit për raportimin e krimeve nga urrejtja - [www.zlostorstvaodomraza.mk](http://www.zlostorstvaodomraza.mk) (shih aktivitetin 4.5 më poshtë). Me kryerjen e këtij aktiviteti, KHM ka regjistruar dhe publikuar 44 krime/incidente nga urrejtja në periudhën prej 1 janar deri në 31 dhjetor 2015.

#### 4.2 Ofrimi i ndihmës ligjore pa pagesë për viktimat

Për dallim prej 2013 dhe 2014 kur KHM është kontaktuar gjithashtu nga ana e viktimave të krimeve nga urrejtja dhe ka pasur mundësinë për të gjetur një numër të viktimave duke kontaktuar mediat të cilat kanë raportuar për ndonjë incident, në 2015 KHM asnjë viktimë e vetme nuk është drejtuar kah KHM-së për ndihmë ligjore. Sidoqoftë, KHM-ja ia arriti të gjejë dy viktima duke kontaktuar televizionin kabllorik Shenja. Përveç kësaj, KHM vazhdoi t'i sigurojë ndihmë ligjore pa pagesë zr. Koço Andonovski (personi i parë që haptazi kishte pranuar se është homoseksual në vend), i cili ishte sulmuar në Sheshin kryesor në Shkup kur përgatitej për Ditën e Tolerancës së pesë marsit të organizuar nga KHM-ja.

Ekzistojnë shumë arsye pse ka rënë numri i viktimave që kanë marrë ndihmë dhe shërbime ligjore pa pagesë në 2015, për dallim prej 2013-2014: 1) numri më i vogël i incidenteve; 2) numër i madh i kryerësve të panjohur; 3) asnjë viktimë nuk i është drejtuar KHM; 4) viktimat që janë refugjatë dhe imigrantë janë larguar nga vendi shpejt pas incidentit; 5) viktimat nuk u janë drejtuar mediave; 6) frika e mundshme nga viktimizimi i dytë dhe 7) mungesë e reagimit të mëparshëm të institucioneve përkatëse të shtetit. Të ballafaquar me këtë problem dhe duke dashur të realizojmë këtë aktivitet të projektit (d.m.th. të sigurohet ndihmë ligjore për viktimat në së paku 3 incidente, siç ishte rasti në 2013-2014 kur u sigurua ndihmë ligjore për viktimat në 10 incidente) KHM dërgoi 78 kërkesa që kishin të bënin me informata në lidhje me incidente derte tek Ministria e Punëve të Brendshme, të gjitha gjykatat dhe të gjitha zyrat themelore të prokurorit publik në vend. Kjo është bërë gjithashtu me qëllim që të zbulohet nëse ndonjë krim/incident nga urrejtja është duke u hetuar apo proceduar në gjyq (shih aktivitetin 4.3 më poshtë), kështu që KHM të jetë në pozitë të takojë viktimat dhe t'u ofrojë shërbimet për ndihmë ligjore pa pagesë. Sidoqoftë, për shkak të çështjeve të privacisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Zyrat e Prokurorisë publike nuk kanë ndarë informata personale të viktimave, përderisa kishte vetëm një rast që ishte në njërin gjykatë të vendit. Sidoqoftë, ai rast kishte të bënte

me procedurë kundër një kryerësi të veprës, pa viktimë në rastin (për shkelje penale për shkakim të urrejtjes nacionale, racore apo fetare, përçarje apo mosdurim).

### 1. Anëtarët e klubit të tifozëve të Vardarit, “Komiti” kanë sulmuar shqiptarët nga fshati Batincë

Incidenti i parë në të cilin është siguruar ndihmë ligjore pa pagesë ka ndodhur në Sheshin kryesor në Shkup më 9 gusht 2015. Pas përfundimit të lojës së futbollit midis KF Vardar dhe KF Shkupi, katër anëtarë të maskuar të klubit të tifozëve “Komiti” kanë arritur në Sheshin kryesor, ku rreth orës 21:45, kanë sulmuar fizikisht tre të mitur duke i goditur me shishe xhami, dhe pastaj janë larguar nga sheshi (për më shumë hollësi shih incidenti nr. 25 në Aneks, apo vizito [www.zlostorstvaodomraza.mk](http://www.zlostorstvaodomraza.mk) ku mund të gjeni një artikull të shkruar me fotografi dhe një video xhirim).

Incidenti është raportuar nga televizioni kabllovik Shenja, pas së cilës KHM ka kontaktuar TV, duke kërkuar informata për identitetin e viktimave të cilët kanë dhënë deklaratat dhe dokumente mjekësore. Ata kanë thënë se edhe pse ka pasur policë në shesh, ata nuk kanë reaguar për incidentin. KHM ka përgatitur ankesë e cila është dërguar tek Sektori për Kontroll të Brendshëm në kuadër të Ministrisë për Punë të Brendshme. Krahas shpjegimit të hollësive të incidenteve dhe të mos aktivitetit të nëpunësve policor, KHM ka propozuar video-xhirimet nga kamerat e sheshit të shqyrtohen me qëllim që të identifkohen kryerësit e veprës. Sektori u përgjigj se policia ka arritur të marrë video xhirimet dhe se ky rast është nën hetime. Më 27 shtator 2015, Ministri i punëve të brendshme në ueb faqen e ministrisë ka informuar se 3 nga kryerësit e veprës janë identifikuar dhe arrestuar. Të gjithë kanë qenë të mitur të moshës 17 vjeçare. Ministria e Punëve të Brendshme ka parashtruar ankesë penale në prokurorinë publike për veprën penale “Dhuna”.

### 2. Incident gjatë marshit të tolerancës në Shkup në 2012

Incidenti i fundit për të cilin është ofruar ndihmë ligjore ka ndodhur më 17 nëntor, 2012. KHM organizoi “Marshin e tolerancës” e pestë, kur është shënuar edhe Dita ndërkombëtare e tolerancës. “Marshi për tolerancë” filloi me një sulm fizik kundrejt dy aktivistëve për të drejta të njeriut - njëri nga të cilët z. Koço Andonovski - gjatë përgatitjes së stendave për OJQ-të të cilat e përkrahnin këtë ngjarje. Policia kapi autorin menjëherë pas incidentit, por procesi gjyqësor filloi në janar të vitit 2014. Vendimi është shpallur në janar 2015. Kryerësi i veprës është dënuar me 7 muaj burgim nga gjykata e shkallës së parë. Sidoqoftë, pasi që vendimi nuk i referohej në veçanti nenit 39 (5) të Kodit Penal (rrethana rënduese në dënimin për shkak të veprës penale të kryer nga paragjykimet), KHM përgatiti një ankesë e cila është dërguar në instancë gjyqësore më të lartë nga paditësi dhe gjithashtu apeloji për pjesën se nuk ka pasur asnjë pengim të tubimit publik në emër të saj me një ankesë të veçantë. Instanca më e lartë gjyqësore e anuloi vendimin e shkallës së parë duke urdhëruar që të përsëritet procesi (për hollësi të tjera në lidhje me procesin gjyqësor dhe ofrimin e ndihmës ligjore pa pagesë shih aktivitetin 4.3 më poshtë).

## 4.3 Monitorimi i rasteve gjyqësore mbi krime nga urrejtja dhe përgjigjeve nga gjyqësori

Me qëllim të realizimit të këtij aktiviteti, KHM dërgoi kërkesa për informata tek Ministria e Punëve të Brendshme për pothuajse secilin aktivitet që ka shënuar. Krahas kësaj janë dërguar kërkesa për 11 incidente të tjera të cilat janë konsideruar si të “dyshimta” por nuk ka mundur të gjendet asnjë tregues specifik i paragjykimet që ato të regjistrohen në [www.zlostorstvaodomraza.mk](http://www.zlostorstvaodomraza.mk) dhe të

inkorporohen në Aneksin që përmban incidentet e krimeve nga urrejtja. Nga 47 kërkesat e dërguara deri tek MPB, KHM ka marrë përgjigje për 45 nga to. Sipas përgjigjeve, katër incidente janë shënuar si kundërvajtje. Përgjigjet nga MPB në të cilat shënohej se është bërë një kallëzim penal, nuk kanë dhënë numrin e ankesës penale të dërguar tek zyrat e prokurorisë publike (shih hollësitë në Aneks). Për një analizë të rasteve, shih “Statusi i rasteve” më poshtë.

Në maj të 2015, KHM ka dërguar kërkesë për informata në lidhje me incidentet që kanë të bëjnë me krime nga urrejtja në të gjitha 31 gjykatat kombëtare (26 themelore, 4 të apelit dhe Gjykatën e Lartë) të cilat kanë të drejtë penale dhe të gjitha 22 zyrat themelore të prokurorisë publike. Kërkesat janë dërguar me postë. Nga gjykatat dhe zyrat e prokurorisë është kërkuar që të japin informata në lidhje me krimet nga urrejtja për periudhën midis 1 mars 2013 deri në kohën kur është siguruar përgjigja (midis 5 majit dhe 13 korrikut 2015). Kërkesat janë dërguar në lidhje me krimet tipike nga urrejtja, siç janë të specifikuara në Kodin Penal:

1. Shkelja e barazisë qytetare (Neni 137)
2. Ekspozimi i popullit dhe kombësive të Maqedonisë në tallje (Neni 179)
3. Shkaktimi i urrejtjes kombëtare, racore ose fetare, përçarje dhe jo tolerancë (Neni 319)
4. Shpërndarja e materialit racor dhe ksenofobik nëpërmjet sistemit të informimit (Neni 394-d)
5. Miratimi apo arsyetimi i gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit apo krimet e luftës (Neni 407-a)
6. Diskriminim racor apo tjetër (Neni 417) dhe
7. Çfarëdo krim tjetër i kryer për shkak të prejdardhjes kombëtare apo sociale të tij, besimit të tij politik apo fetar, gjendjes material apo sociale, gjinisë, racës apo ngjyrës së lëkurës (Neni 39(5)).

Në një periudhë mesatare prej një muaji, të gjitha 31 gjykata dhe 22 zyra të prokurorisë publike kanë dërguar përgjigjet e tyre në KHM. Më poshtë gjendet radhitja e përgjigjeve:

Kërkesa të dërguara:	53
Përgjigje të marra:	53
Përgjigje pozitive:	11 (4 gjykatat themelore, 1 gjykata e apelit, 6 zyrat e PP-së)
Raste në 2 vitet e fundit:	42 (7 gjykatat themelore, 5 gjykata e apelit, 30 zyrat e PP-së)
Rastet e përfunduara:	32 (5 është miratuar vendimi final, 27 refuzuar nga zyrat e PP-së)
Rastet në vazhdim:	4 (3 zyrat e PP-së /hetim, 1 gjykata themelore)

Përgjigjet pozitive janë dërguar nga zyrat e PP-së në Manastir, Gjevgjeli, Shkup, Strugë dhe Tetovë, gjykatat themelore në Kërçovë, Shkup, Strugë dhe Gjykatën e Apelit në Gostivar. Vetëm disa nga gjykatat kanë ndarë hollësitë në lidhje me gjatësinë dhe/apo llojin e dënimeve të shqiptuara. Në fund të 2015, KHM ka dërguar kërkesa shtesë për të marrë të gjitha verdiktet finale që posedojnë gjykatat. Gjykimet dhe vendimet janë dërguar tek KHM nga të gjitha gjykatat.

Gjykata Themelore Shkup I ka siguruar një Vendim KC-KP.6p.1427/13 për një rast i cili ka të bëjë me një viktimë në fjalë, e cila është transseksual, për vepër penale Shkelje të barazisë qytetare (Neni 137, Kodi Penal). Viktima është ankuar se presidenti i Komisionit për Mbrojtje kundër Diskriminimit ka shkelur barazinë e saj për shkak se e ka nënshkruar vendimin e miratuar nga Komisioni, me të cilën

ankesa e dorëzuar në 2011 nga viktimi në fjalë është anuluar. Pasi që është refuzuar kallëzimi penal i paraqitur nga viktimi e supozuar deri tek Zyra e Prokurorisë publike në Shkup (ZPP ka konsideruar se shkelja penale nuk ndiqet sipas detyrës zyrtare), viktimi e supozuar ka vazhduar procedurat para Gjykatës Themelore Shkup I nëpërmjet një padie tjetër penale. Gjykata vendosi të refuzojë aktpadinë duke u arsyetuar se presidenti vetëm ka nënshkruar vendimin e Komisionit, përderisa Komisioni ka qenë trupi i cili është dashur ta miratojë atë pasi që ka marrë parasysh me kujdes faktet.

Gjykata Themelore në Kërçovë ka siguruar dy vendime, K.nr.68/2013 dhe K.nr.54/2013. Rasti K.nr.68/2013 ka të bëjë me një autor krimi i cili ka kryer veprën penale ka kryer veprën penale e definuar me Nenin 179 të Kodit Penal. Shkelësi, qytetar me përkatësi etnike maqedonase, në shkurt të v. 2013, duke qëndruar në ballkonin e tij, si rezultat i gjendjes së tij mentale – skizofreni paranojike – ka filluar ti bërtas “Ju jeni shiptarë, ju jeni mbeturina, kjo nuk është e juaja, shkoni që këtej!” një familjeje me origjinë etnike shqiptare. Disa ditë më vonë, personi është paraqitur para derës e cila çon tek shtëpia e familjes së njëjtë dhe ka filluar të bërtasë “shiptarët mund të mos jetojnë këtu, shiptarët janë të fëlliqur, lëshoni shtëpinë sepse nuk ka vend për shiptarët këtu, kjo është tokë maqedonase, nëse nuk largoheni do të djeg tërë familjen tuaj”. Sipas Gjykatës Themelore në Kërçovë, duke vepruar kështu, kryerësi ka kryer veprën penale ka kryer veprën penale e definuar me Nenin 179 të Kodit Penal. Gjykata ka urdhëruar masë sigurie gjashtëmujore kundrejt kryerësit, duke imponuar trajtimit të detyrueshëm në një institucion psikiatrik. Rasti K.nr.54/2013 ka të bëjë me një padi penale të parash-truar nga një mjek ndihmës kundrejt katër infermiereve. Ai pretendonte se ato kanë kryer më shumë se 30 vepra penale. Pasi që shumica e atyre shkeljeve bartnin dënim më të gjatë se 3 vite, Gjykata Themelore në Kërçovë e ka dërguar lëndën te Gjykata Themelore në Gostivar.

Gjykata Themelore në Prilep ka dhënë një Vendim K.nr.110/13 për një rast i cili përfshin një kryerës, një maqedonas me origjinë turke, një i punësuar në shkollë fillore, i cili në nëntor të 2012 ka hyrë në njërën nga zyrat e shkollës dhe është pyetur nga katër mësuese femra për transportin e tyre deri në shkollë. Ai pastaj është përgjigjur duke bërtitur “Ne do të vendosim se kush do t’u vozisë juve!”. Kur njëra nga mësueset ka kërkuar që të mos bërtasë sepse gjendet në zyrë të mësuesit, ai ka bërtitur “Zyrën tënde!? Ti e ke humbur shtetin, për katër vite, në Komunën e Dollnenit, nuk do të ketë asnjë maqedonas këtu!” Gjykata Themelore në Prilep ka konsideruar këtë si Diskriminim racor apo tjetër (Neni 417, Kodi Penal). Gjykata ka imponuar një dënim trevjeçar me kusht i cili nuk do të realizohet nëse kryerësi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale në kohë prove për periudhë njëvjeçare. I fundit, një rast i cili ishte ende në vijim në Gjykatën Themelore në Strugë. Rasti K.nr.227/14. Ka të bëjë me një kryerës i cili është i paditur për Shkaktim të urrejtjes kombëtare, racore ose fetare, përcarje dhe jotolerancë (Neni 319, Kodi Penal).

Për shkak të vështirësive për të marrë të dhënat në lidhje me proceset në vazhdim që kanë të bëjnë me krimet nga urrejtja (shih shpjegimin nën aktivitetin 4.2 më lartë) KHM ishte në gjendje të kryejë monitorim të drejtpërdrejtë të procesit gjyqësor në lidhje me incidentin gjatë “Marshit të tolerancës” në Shkup në 2012. KHM ka monitoruar procesin K.nr.1644/13 në Shkup. Ky proces ka të bëjë me orientimin seksual si bazë mbi të cilën kryerësi i veprës ka sulmuar dy aktivistë të OJQ-ve, njëri nga të cilët ishte z. Koço Andonovski, drejtor i programit të Qendrës së LGBTI në Shkup, në sheshin kryesor të qytetit të Shkupit në vitin 2012. Duke marrë parasysh se KHM konsideron këtë rast si rast strategjik, ia arriti të sigurojë avokat mbrojtës që t’i përfaqësojë viktimat pa pagesë. Ky rast përfshin këto akuza penale: Dhunë (paditur nga Shteti), Pengim i një tubimi publik (paditur nga KHM) dhe lën-

dim i barazisë së qytetarëve (paditur nga z. Andonovski dhe aktivistët e tjerë të lënduar të të drejtave të njeriut). Zyra e Prokurorit Publik iu bashkëngjiti rastit në v. 2014, pas hetimeve të bëra mbi këtë rast për një vit e gjysmë.

Pasi ishte shpallur vendimi në janar të vitit 2015, kryerësi i veprës është dënuar me 7 muaj burgim nga gjykata themelore për Dhunë dhe pengim të një tubimi publik, por padia për lëndim të barazisë së qytetarëve është shkarkuar nga gjykata. Vendimi i gjykatës themelore nuk i referohet veçanërisht Nenit 39 (5) të Kodit penal (rrethanat rënduese në dënim si rezultat i shkeljes penale të kryer nga paragjykimi) për cilat arsye KHM përgatiti një ankesë e cila u dërgua në instancë gjyqësore më të lartë për apel nga ana e të akuzuarit si dhe një ankesë tjetër në emër të KHM-së në lidhje me pengimin e një tubimi publik. Në dhjetor 2015 instanca gjyqësore më e lartë nëpërmjet Vendimit të saj KZh-990/15 e rrëzoi vendimin e shkallës së parë dhe urdhëroi që procesi të përsëritet. Në arsyetimin e saj, midis të tjerash, gjykata e lartë tha se vendimi është i pakuptueshëm dhe se gjykata e shkallës së parë do të duhet të adresojë çështjet e ngritura në të dyja ankesat e përgatitura nga KHM-ja.

#### 4.4 Raportimi i krimeve nga urrejtja dhe incidenteve nga urrejtja tek OSBE/ODIHR

Midis 1 janarit dhe 31 dhjetorit 2015, KHM ka regjistruar 44 krime/incidente nga urrejtja. 31 incidente janë verifikuar, përdërisa 13 janë ende të paverifikuara. (Përkatësia etnike (16 incidente), statusi i refugjatit apo emigruesit (21) dhe përkatësia politike (5 incidente) përfaqësojnë pjesën më të madhe të arsyeve nën të cilat janë kryer veprat e krimit në 2015. Krahas kësaj, 7 incidente kanë ndodhur gjatë apo pas ndeshjeve sportive midis ekipeve të cilat janë të përkrahura nga maqedonasit dhe anëtarë të bashkësisë shqiptare në vend. Viktimat dhe kryerësit e veprave janë zakonisht anëtarë të përkatësive të ndryshme etnike (maqedonas, shqiptar, maroken, sirian, irakian dhe afgan) apo përkrahës të të dyja partive më të mëdha politike në vend (LSDM dhe VMRO-DPMNE).

Shumica e krimeve të supozuara përfshijnë: Dhunë(21), plaçkitje (20), lëndime apo lëndime të rënda në trup (17) dhe dëmtim i pronës së tjetrit (6). Hollësitë në lidhje me incidentet, siç janë përkrahim i shkurtër, data, koha, lokacioni, burimi i informatave, viktimat(t) e përfshir(a), kryerësit e veprës, statusi i rastit, përgjigja nga autoritetet dhe ndikimi mbi viktimën(-at) dhe bashkësinë mund ti gjeni tek Aneksi “Incidentet e krimeve nga urrejtja në 2015” të këtij raporti. Në Aneksin e njëjtë, ka një fushë “tregues të urrejtjes”, e cila është përfshirë në çdo incident të ndarë. Përfshin të dhëna mbi: Perceptimin e viktimës/dëshmitarit; komentet e bëra në vendin e ngjarjes; dallimi midis viktimës dhe kryerësit të veprës në baza etnike; mostra/frekuenca e incidenteve të mëparshme; *Natyra e dhunës*; mungesa e motiveve tjera; dhe lokacioni dhe koha. Krahas sigurimit të informatave shtesë në lidhje me incidentet, ky seksion është veçanërisht i dobishëm për të kuptuar pse një incident i pa verifikuar është përfshirë në këtë raport.

#### 4.5 Mirëmbajtja e një ueb-faqeje interaktive për raportimin e krimeve nga urrejtja

Ueb-portali - [www.zlostorstvaodomraza.com](http://www.zlostorstvaodomraza.com) (që nga 2014 është në dispozicion gjithashtu edhe si [www.zlostorstvaodomraza.mk](http://www.zlostorstvaodomraza.mk)) është një vegël interaktive që u mundëson qytetarëve të pranojnë informata dhe raportim për krimet nga urrejtja. Përmban një hartë interaktive që tregon se ku gjendet saktësisht apo përafërsisht lokacioni i incidenteve. Faqja kryesore radhit kategoritë e krimeve nga urrejtja dhe motivet anësore, jep informata në lidhje me mënyrën se si mund të raportojnë qytetarët (e-aplikacionet, twitter, email dhe formën onlajn) dhe paraqet grafikët statistikorë. Në ueb-portalin gjenden gjithashtu seksionet me Pyetjet me të shpeshta, Burimet dhe Fjalorin, ku janë dhëna infor-



mata në lidhje me projektin, kuptimin dhe shtrirjen e krimeve nga urrejtja dhe botimeve në lidhje me këto krime. Në 2015 mediat vazhduan ta përdorin portalin si burim të besueshëm, duke përdorur të dhëna dhe screenshot nga portali në ueb-faqet e tyre.

Në 2015, Raporti vjetor mbi krimet nga urrejtja në vend në 2014, i përgatitur nga KHM është vendosur në këtë portal në gjuhët maqedonase, shqipe dhe angleze. Gjatë periudhës së raportimit, 44 incidente, mbi 10 fotografi, 4 video dhe dokument si resurs janë vendosur në këtë portal. Përkufizimet e krimeve të caktuara dhe rrethanat rënduese gjatë dënimit janë përditësuar me bazat e reja të krimeve nga urrejtja të vendosura me ndryshimet e bëra tek Kodi Penal në v. 2014 (shih seksionin e Fjalorit tek ueb-faqja). Krahas kësaj, portali tani është në dispozicion në gjuhën angleze dhe shqipe dhe shumica e incidenteve të regjistruara dhe e përmbajtjeve të portalit mund të lexohen edhe në këto gjuhë.

#### **4.6 Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë qytetare në ngritjen e vetëdijes**

KHM iu përgjigj një ftese për pjesëmarrje në një rrjet joformal evropian për viktimat e krimeve nga urrejtja, të udhëhequr nga RAA Sachsen, një OJQ gjermane e cila punon në fushën e krimeve nga urrejtja. Janë organizuar dy punëtori në Berlin në mars dhe maj të 2015. Tema e punëtorive ishte “Udhëzues dhe standarde për mbështetje të viktimave të krimeve nga urrejtja në Evropë”. Një botim mbi këtë temë pritet të dalë në mars të 2016. Në gusht 2015, një anëtar i ekipit të projektit mbajti dy ligjërata në Akademisë Verore të Forumit Edukativ Rinor në Shkup. Tema e ligjëratës ishte “Të rinjtë dhe policia”. Në dhjetor 2015, një anëtar i ekipit të projektit mori pjesë në Konferencës e OSBE-së për shoqëri paralele qytetare në Beograd gjatë së cilës bëri një prezantim mbi temën “Refugjatët, viktimat të krimit nga urrejtja” në vend. Në konferencë morën pjesë më shumë se 100 përfaqësues nga rajoni i OSBE-së. Anëtarët e ekipit morën pjesë edhe në konferenca dhe ngjarje të tjera jashtë vendit (Mal të Zi dhe Kroaci) dhe morën pjesë në trajnime si ligjërues për gjyqësorin (Shkup) dhe policinë (Strumicë). Krahas kësaj, KHM ka përfshirë edhe një seksion të ndarë për krimet nga urrejtja në raportet e veta mujore (për muajt ku është regjistruar një numër i konsiderueshëm i krimeve nga urrejtja) mbi situatën me të drejtat e njeriut në vend, të cilat shpërndahen deri tek institucionet shtetërore, mediat, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat e huaja në vend. Në fund, KHM vazhdoi me përditësimin e faqes së vet në Facebook për ndërgjegjësim ndaj krimeve nga urrejtja (<http://goo.gl/8yY5Lk>) dhe faqes në Twitter (<https://twitter.com/HateCrimesMK>).

#### **4.7 Ngritja e vetëdijes në shkollat të mesme ku janë regjistruar incidente nga urrejtja**

Së bashku me Institutin për të Drejta të Njeriut dhe Paqes nga Kaen, Francë, KHM ka organizuar një Shkollë verore për të rinjtë në gusht të 2015. Fokusi i veçantë i shkollës verore ka qenë mbi krimet nga urrejtja dhe gjuha e urrejtjes në vend dhe në Francë. Njëzet nxënësve u janë ofruar ligjërata të përbashkëta nga ekspertë nga vendi dhe Franca (10 nga vendi dhe 10 nga Franca) të moshës prej 19 deri në 24 vjet. KHM kishte 5 vende të rezervuara për nxënësit e shkollave të mesme të cilët kanë mësuar në shkollat ku janë regjistruar më së shumti krime nga urrejtja midis viteve 2013 dhe 2015. 3 nga 10 vendet janë plotësuar nga kandidatë prej shkollave siç janë Pançe Karagjovov, Mari Skłodovska-Kiri, dhe Arseni Jovkov

#### **4.8 Grupi punues për ndryshimet në legjislacion për krimet nga urrejtja**

Koordinatori i projektit u bë anëtar i Grupit punues për amendamentet e legjislacionit për krimet nga urrejtja. Krahas OSBE-së dhe KHM-së, grupi përbëhej nga përfaqësues të institucioneve shtetërore (MPB, MD, Zyra Themelore e Prokurorit Publik në Shkup, Gjykata e Apelit në Shkup, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve (ASHAM) dhe përfaqësues

nga akademia dhe sektori i OJQ-së. Pesë takime janë mbajtur në Akademinë e Shkencave dhe Ar-teve në vend të kryesuar nga kryetari i Akademisë. Në fund të 2015, propozim amendamentet ishin prezantuar në një konferencë me palët e interesit në Akademinë për Gjykatës dhe Prokuror Publikë në Shkup. Puna e grupit punues ishte lavdëruar dhe kishte marrëveshje të gjerë midis përfaqësuesve të institucioneve shtetërore që amendamentet e këtilla janë me të vërtetë të domosdoshme, në veçanti në lidhje me Kodin Penal dhe ligjet që e rregullojnë punën e policisë. Grupi punues pranoi një numër të madh vërejtjesh dhe komentesh të bëra nga palët e përfshira, me qëllim të përmirësimit të amendamenteve, ndërsa ato tani janë në versionin e fundit të tyre të hartuar, të gatshme për t'u propozuar për miratim nga Parlamentit.

#### 4.9 Shënimi i 22 korrikut- Ditës Evropiane të Viktimave nga Krimet e Urrejtjes

KHM shënoi 22 korrikun - Ditën Evropiane për Viktimat e Krimit nga Urrejtja duke organizuar dy ngjarje të ndryshme. Ngjarja e parë përbëhej nga një konferencë për shtyp për mediat, kurse ngjarja e dytë ishte organizuar si një kontribut i ngjashëm në parkun e qytetit në Shkup. U organizua për herë të dytë pas të parës në 2014, dhe është titulluar "Turlitavë 2-Së bashku është më e shijshme". Ngjarja përfshinte fjalime, muzikë, shoqërim midis pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme etnike duke degustuar ushqimin tradicional të maqedonasve, shqiptarëve, turqve, romëve, serbëve, boshnjakëve dhe vlllehve (siç është Turlitava- një ushqim tradicional ballkanik).

## 5. PËRFUNDIMET

- Shteti nuk grumbullon të dhëna mbi krimet nga urrejtja megjithëse ka përgatitje fillestare nga ana e gjyqësorit që të fillohet me regjistrimin e këtij lloji krimesh, nuk është e sigurt se a do të ketë të dhëna zyrtare gjithëpërfshirëse dhe krahasuese në një të ardhme të afërt.
- Numri i incidenteve midis maqedonasve dhe shqiptarëve etnikë ka rënë në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me 2013 dhe 2014.
- Viktimat nuk dëshirojnë që të përmenden emrat e tyre, nuk duan as piblicitet, as t'u drejtohen institucioneve shtetërore, duke u frikësuar nga pasojat të cilat çojnë drejt mosraportimit të mjaftueshëm dhe mungesës së besimit të popullit në sistem.
- Janë bërë shumë pak përpjekje për masat parandaluese duke përfshirë këtu edhe edukimin mbi të drejtat e njeriut dhe ngritjen e vetëdijes midis popullsisë.
- Krimet e motivuara nga paragjykimet ende nuk janë raportuar apo hetuar si duhet nga.
- Praktikuesit relevant kanë filluar të marrin trajnime në lidhje me identifikimin dhe reagimin e incidenteve nga urrejtja përmes Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së.
- Duke mos trajtuar fenomenin e krimit nga urrejtja si një çështje të ndarë, shteti nuk ofron mbrojtje të veçantë apo mbështetje për viktimat.

- Anëtarët më të prekur ishin refugjatët që po kalonin nëpër shtet në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian, por gjithashtu edhe rinia e vendit.
- Krimet nga urrejtja zakonisht ndodhin në vend publik apo përgjatë Autostradës Panevropiane të Korridorit X.
- Disa nga krimet nga urrejtja janë kryer nga hakmarrja apo pasoja pas një incidenti paraprak midis rinisë maqedonase dhe shqiptare.

## 6. REKOMANDIME

Gjatë takimit të Këshillit të BE-së për drejtësi dhe çështjet vendore, të mbajtur në Bruksel më 5-6 dhjetor, 2013, Këshilli botoi përfundimet e veta në lidhje me luftimin e krimeve nga urrejtja në BE. Si shtet që aspiron të bashkëngjitet në BE, vendi duhet të ndjekë rekomandimet të cilat gjenden përfundimet të cilat janë në përputhje me rekomandimet e përmbajtura në Vendimin e Këshillit të Ministrave të OSBE-së Nr. 9/09: Luftimi i krimeve nga urrejtja, dhe vështrimi i KHM-së. Këto rekomandime janë bërë në Raportin vjetor mbi krimet nga urrejtja në 2014, por duke marrë parasysh se shteti dështoi në zbatimin e tyre, të njëjtat po përsëriten edhe në këtë raport.

1. Të merret parasysh përvoja e vendeve anëtare të BE-së në zgjerimin e legjislacionit të tyre penal, e spektrit të veprave të dënueshme të krimeve nga urrejtja apo motiveve të tjera nga paragjykimi;
2. Të sigurohet hetim dhe ndjekje e shpejtë dhe efikase e krimeve nga urrejtja duke parasysh motivet e anshme gjatë procedurës penale;
3. Të merren masa të përshtatshme që të lehtësohet raportimi i krimeve nga urrejtja nga viktimat sa të jetë e mundur, gjithashtu, të përforcohen e shoqatat të cilat i përkrahin ata, duke përfshirë edhe masa për të krijuar besimin tek policia dhe tek institucionet e tjera shtetërore;
4. Të grumbullohen dhe botohen të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme në lidhje me krimet nga urrejtja, sa më shumë që mundet duke përfshirë edhe numrin e incidenteve të tilla të raportuara nga policia dhe të regjistruara nga organet e ndjekjes; numrin e aktvendimeve; motivet e paragjykitimit e pas këtyre krimeve; dhe dënimet që u janë shqiptuar autorëve të krimet;
5. Të sigurohen se viktimat e krimeve nga urrejtja të ndihmohen, përkrahen dhe mbrohen;
6. Të promovohen trajnime për praktikuesit relevantë të cilët vijnë në kontakt me viktimat e krimeve nga urrejtja, duke u mundësuar që të ndihmojnë këto viktimat në mënyrë efikase;
7. Të përmirësohen masat parandaluese, midis të tjerash, në mënyrë të tillë që të reflektojnë rikujtim të edukimit mbi të drejtat e njeriut, të programeve arsimore në lëndën e historisë dhe trajnimit përkatës, duke ndërmarrë hapa për edukim të publikut mbi vlerën e dallimeve kulturore dhe gjithëpërfshirjes, duke synuar që të gjitha pjesët e shoqërisë të kenë rol në luftën kundër mostolerancës së tillë.

## INCIDENTET NGA KRIMET E URREJTJES NË 2015

### 1. Emigrantë të plaçkitur në afërsi të Negotinës (e paverifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Gjashtë emigrantë janë plaçkitur nga kryerësi i panjohur, i cili mori 100 euro prej tyre.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 3 janar, koha e papërcaktuar, fshati Përxehevë, Negotinë.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike Plusinfo.

**Viktima(t) e përfshira:** Gjashtë shtetas afganë.

**Lloji i krimit (eve):** Plaçkitje (neni 237 i kodit penal).

**Kryerësi (s):** Një mashkull 55 vjeçar.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykitimit:** Në këtë incident, motivi i paragjykitimit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, dhe treguesit të paragjykitimit janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - përkatësia etnike e autorëve dhe të viktimës dallojnë; viktimat janë anëtarë të një grupi (emigrantëve afganë) të cilët janë të paktë dhe në numër të vogël për dallim nga një grup tjetër (i popullsisë maqedonase), në zonën ku ndodhi incidenti;

**Statusi i rastit:** Është ngritur kallëzim penal.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacione me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se kanë paraqitur kallëzim penal kundër një personi.

**Ndikimi mbi viktimën dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje sigurinë e hyrjes dhe kalimit nëpër vend.

### 2. Zyra e degës së “Lidhjes Socialdemokratike të Maqedonisë.” (LSDM) e në Maxhari është qëlluar me gurë, Shkup (e verifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Persona të panjohur vandalizuan zyrën e degës së partisë, duke thyer disa dritare. Pas incidentit, rreth zyrës u ndezën disa qirinj.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 8 janar, orët e para, Maxhari, Shkup.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike Lokalno.

**Viktima(t) e përfshira:** Përveç dëmeve materiale, nuk ka pasur viktima të drejtpërdrejta në këtë incident.

**Lloji i krimit:** Dëmtimi i pronës së huaj (neni 243 i Kodit Penal).

**Kryerësi(t):** Të panjohur.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykitimit:** Në këtë incident, motivi i paragjykitimit është përkatësia politike, dhe treguesit e paragjykitimit janë:

1. *Lokacioni i objektivit* - Objektivi është zyra e degës së partisë më të madhe opozitare;

2. *Gjestet në vendngjarje* - Pas incidentit kryerësit kanë ndezur disa qirinj rreth zyrës;

3. *Mungesa e motiveve tjera.*

**Statusi i rastit:** nën hetim.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik,

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se po ndërmarrin masat e nevojshme për sqarimin e rastit.

**Ndikimi mbi viktimën dhe bashkësinë:** Ky lloj incidentesh vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në vend.

### 3. Katër shtetas sirianë janë sulmuar dhe plaçkitur në afërsi të Gradskos (e verifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Në rrugën Gradsko - Veles, në afërsi të vendit të quajtur Venule, disa persona të panjohur kanë sulmuar dhe plaçkitur katër shtetas sirianë, duke marrë paratë, telefonat celularë, dhe pasaportat siriane.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 21 janar, ora 16:30, në rrugën Gradsko - Veles, në afërsi të vendit të quajtur Venule.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike Republika.

**Viktima(t) e përfshira:** Katër shtetas sirianë.

**Lloji i krimit:** Plaçkitje (237 i Kodit Penal), Dhunë (Neni 386 i Kodit Penal).

**Kryerësi(t):** Grup i panjohur i disa autorëve.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykitimit:** Në këtë incident, motivi i paragjykitimit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, dhe treguesit e paragjykitimit janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike*, - përkatësia etnike e autorëve dhe e viktimës dallojnë; viktima është anëtar i grupit (emigrantë sirianë) i cili është në numër jashtëzakonisht të paktë nga anëtarët e grupit tjetër (të popullsisë maqedonase), në zonën ku ka ndodhur incidenti;

**Status i rastit:** Incidenti është raportuar tek autoritetet lokale.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, MPB nuk i është përgjigjur kërkesës për informim publik të cilin Komiteti e ka dërguar lidhur me këtë incident. Megjithatë, ata kanë raportuar nëpërmjet mediave që kanë ndërmarrë masat e nevojshme për sqarimin e rastit.

**Ndikimi mbi viktimën dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve që hyjnë dhe kalojnë përmes vendit.

### 4. Goditje me thikë në Qendrën Tregtare Mavrovasja, Shkup (e paverifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Tre persona të panjohur kanë sulmuar tre të rinj nga fshati Haraçinë dhe një nga Shkupi, duke shkaktuar plagë me thikë. Të gjithë u dërguan në spital, ku një viktimë u diagnostifikua me plagë të rënda trupore, dhe tre të tjerë me plagë të lehta.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 26 janar, ora 18:30, Qendra Tregtare Mavrovasja, Shkup.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike Plusinfo.

**Viktima(t) e përfshira:** Dy 18 dhe një 23-vjeçar, meshkuj nga Haraçina, dhe një 21-vjeçar, mashkull nga Shkupi.

**Lloji i krimit (eve):** Dhunë (Neni 386 i kodit penal), rrezikimi me mjet të rrezikshëm gjatë përlëshjes apo fjalimit (neni 133 i kodit penal), dëm trupor (neni 130 i kodit penal), dëm i rëndë trupor (neni 131 i kodit penal).

**Kryerësi(t):** Grupi i panjohur i tre autorëve.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykitimit:** Në këtë incident, motivi i paragjykitimit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, dhe treguesit e paragjykitimit janë:

1. *Model nga incidente të mëparshme*- incidenti ka ndodhur në një zonë ku kanë ndodhur krime të shumta të urrejtjes dhe të sulmeve të dhunshme në vitin 2013 dhe 2014;

2. *Natyra e dhunës* - incidenti ka ndodhur në vend publik;

3. *Mungesa e motiveve tjera*.

**Status i rastit:** Është dorëzuar kallëzim penal.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se rasti është regjistruar si dhunë (neni 386 i kodit penal). Megjithatë, kur rasti është sqaruar, MPB-ja ka ngritur tetë padi penale për veprën penale të pjesëmarrjes në një përlshje (neni 132 i kodit penal). Kjo do të thotë se ankesa penale janë ngritur edhe kundër viktimave.

**Ndikimi mbi viktimën (at) dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy komuniteteve më të mëdha në vend.

## 5. Përlshje dhe të shtëna në Aerodrom, djalë 14 vjeçar i plagosur (e paverifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Dy persona të panjohur kanë sulmuar dy djem gjashtëmbëdhjetë vjeçarë dhe një djalë katërmëdhjetë vjeçar në një parking prapa Qendrës Tregtare Kapitol. Viktimat arritën të shpëtojnë, por ata u ndanë. Autorët ndoqën dhe kapën djaloshin 14 vjeçar, dhe përsëri e sulmuan atë. Pasi që ai arriti të arratisë për herë të dytë, autorët u kthyen në QT Kapitol dhe qëlluan disa herë me armë zjarri në drejtim të panjohur. Djali 14 vjeçar u dërgua në spital, ku u diagnostifikua me lëndime trupore.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 27 janar, 2015, Komuna e Aerodromit, Shkup.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike MKD.

**Viktima(t) e përfshira:** Dy djem 16 vjeçarë dhe një djalë 14 vjeçar nga Shkupi.

**Lloji i krimit (s):** Dhunë (Neni 386 i kodit penal) Rrezikimi i sigurisë (Neni 144 i kodit penal), dëm trupor (neni 130 i kodit penal).

Kryerësi: Dy persona të panjohur.

**Përkthim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykit:** Në këtë incident, motivi i paragjykit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, dhe treguesit e paragjykit janë:

1. *Dallim i mundshëm në përkatësinë etnike midis autorëve dhe viktimave* - incidenti ka ndodhur në një zonë të populluar kryesisht nga maqedonas. Megjithatë, mediat raportojnë se një djalë 16 vjeçar është marrë në paraburgim nga policia, në stacionin policor Bit Pazar, e cila ka juridiksion mbi një zonë të populluar kryesisht nga shqiptarët;

2. *Natyra e dhunës* - incidenti është kryer në vend publik;

3. *Mungesa e motiveve të tjera.*

**Status i rastit:** Incidenti është raportuar tek autoritetet lokale.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se akuzat penale kundër dy autorëve që janë ngritur janë vepra e dhunës dhe e rrezikimit të sigurisë.

**Ndikimi mbi viktimën dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy komuniteteve më të mëdha në vend.

## 6. Anëtarët e klubit mbështetës të Shvercerëve sulmuan tifozët e KF Skopje (e verifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Pas ndeshjes së futbollit midis KF Shkupi dhe KF Skopje, dhjetë anëtarë të klubit mbështetës Shvercerët (KF Shkupi) sulmuan tifozët e KF Skopje. Kur policia u përpoq për të ndaluar një anëtar nga KM Shvercerët, ata u penguan nga një tjetër.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 28 Shkurt, ora 16:00, Stadiumi Metalurg, Shkup.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike Plusinfo.

**Viktima(t) e përfshira:** Numër i panjohur i tifozëve të KF Skopje.

**Lloji i krimit (eve):** Dhunë (Neni 386 i kodit penal), pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së punës zyrtare (Neni 382 i kodit penal).

**Kryerësi(t):** Një grup prej dhjetë anëtarësh të KM Shvercerët.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjyimit:** Në këtë incident që ndodhi gjatë një ndeshjeje sportive, motivi i paragjyimit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, dhe treguesit e paragjyimit janë:

1. *Dallimi në prejardhjen etnike* - anëtarët e KM Shvercerët janë shqiptarë, ndërsa tifozët e KF Skopje janë kryesisht maqedonas;
2. *Koha* - incidenti ka ndodhur pas një ndeshjeje futbollit ndërmjet klubeve me përkrahës / tifozë ndërmjet përkatësi të ndryshme etnike, pas një ndryshimi të pranisë së pakicës në zonë (përkrahës shqiptarë në një lagje të populluar kryesisht nga maqedonas);
3. *Natyra e dhunës* - incidenti është kryer në vend publik;
4. *Mungesa e motiveve të tjera.*

**Status i rastit:** Janë ngritur padi penale.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se kanë ngritur kallëzim penal kundër dy të dyshuarve për veprën penale të dhunës.

**Ndikimi mbi viktimën dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në vend dhe sigurinë e njerëzve të pranishëm në ndeshjet sportive.

## 7. Shtetasi sirian është sulmuar dhe plaçkitur (e paverifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Shtetasi sirian është sulmuar nga dy persona të panjohur, të cilët morën 1.600 euro prej tij. Ai u dërgua në spital, ku ai u diagnostifikua me lëndime trupore dhe u mbajt për trajtim të mëtejshëm.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 17 mars, ora 19:45, Negotinë.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike Makfax.

**Viktima(t) epërfshira:** Një shtetas sirian.

**Lloji i krimit:** Plaçkitje (neni 237 i kodit penal), dëm trupor (neni 130 i kodit penal).

**Kryerësi(t):** Grup i panjohur i tre autorëve.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjyimit:** Në këtë incident, motivi i paragjyimit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, dhe treguesit e paragjyimit janë:

2. *Dallimi në prejardhjen etnike* - përkatësia etnike e autorëve dhe viktimës dallojnë; viktima është anëtar i grupit (emigrant sirian) i cili është i paktë në numër për dallim nga anëtarët e një grupi tjetër (të popullsisë maqedonase), në zonën ku ka ndodhur incidenti;
3. *Natyra e dhunës* - incidenti është kryer në vend publik;

**Statusi i rastit:** Incidenti është raportuar tek autoritetet lokale.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, MPB nuk i është përgjigjur kërkesës për informim publik të cilën e ka dërguar Komiteti në lidhje me këtë incident.

**Ndikimi mbi viktimën dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve që hyjnë dhe kalojnë përmes vendit.

## 8. Një grup i të rinjve sulmuan tre persona në Tetovë (e paverifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Një grup i madh i të rinjve sulmuan dy nxënës të shkollës së mesme dhe një mashkull 26 vjeçar në oborrin e shkollës fillore "Andrea Savevski-Kikish", duke u shaktuar atyre lëndime trupore në pjesën e qafës dhe kokës.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 19 mars, ora 12:45, në oborrin e shkollës fillore "Andrea Savevski-Kikish", Tetovë.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike Lokalno.

**Viktima(t) e përfshira:** Tre të rinj, dy prej të cilëve janë të mitur.

**Lloji i krimit:** Dhunë (neni 386 i kodit penal), lëndime trupore (neni 130 i kodit penal).

**Kryerësi(t):** Grup i madh i panjohur i të rinjve.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykit:** Në këtë incident, motivi i paragjykit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, dhe treguesit e paragjykit janë:

1. *Dallimi i supozuar në përkatësinë etnike* - incidenti ka ndodhur në një zonë të populluar me përbërje të përzier etnike;
2. *Natyra e dhunës* - incidenti është kryer në vend publik;
3. *Mungesa e motiveve të tjera.*

**Statusi i rastit:** Janë ngritur kallëzime penale.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) u përgjigj se janë ngritur kallëzime penale kundër gjashtë personave.

**Ndikimi mbi viktimën dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në vend.

## 9. Është djegur automobili i një aktivisti të LSDM-së në Manastir (e paverifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Automjetit të një anëtari dhe aktivisti të njohur të LSDM-së iu vu zjarri.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 14 prill, ora 02:45. Rruga Todor Daskalo, Manastir.

**Burimi i informacionit:** Internet portali Dnevnik.

**Viktimat e përfshira:** Përveç dëmeve materiale, nuk ka pasur viktima të drejtpërdrejta në këtë incident. Llojet e krimit: Dëmtimi i pronës së të tjerëve (neni 243 i kodit penal), Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm (neni 288 i kodit penal).

**Kryerësi:** I panjohur.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykit:** Në këtë incident, motivi i paragjykit është përkatësia politike dhe bindja politike, dhe treguesi i paragjykit është:

1. *Perceptimi i viktimave* - sipas një deklaratë të dhënë për mediat, viktima e percepton këtë incident si të motivuar me paragjykim;
2. *Natyra e dhunës* - incidenti është kryer në vend publik;
3. *Mungesa e motiveve tjera.*

**Statusi i rastit:** Incidenti është raportuar te autoritetet.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) u përgjigj se po ndërmerren masa të nevojshme për sqarimin e rastit.

**Ndikimi mbi viktimën dhe bashkësinë:** Ky lloj incidenti e vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në vend.

## 10. Tifozët e Klubit të Futbollit Shkupi sulmuan lojtarët e KF Vardarit (të rinjtë) (e verifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Tifozët e KF Shkupi-1927, sulmuan lojtarët e KF Vardar (të rinj). Incidenti ka ndodhur pas ndeshjes të futbollit, kur përkrahësit kërcyen mbi gardhin e sigurisë dhe sulmuan lojtarët, kur ata po largoheshin nga stadiumi.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 15 prill, ora 18:00, Stadiumi Çair, Shkup.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike Makfax .

**Viktimat e përfshira:** Numër i panjohur i lojtarëve të KF Vardarit (të rinjtë).

**Lloji i krimit (s):** Dhunë (neni 386 i kodit penal).



**Kryerësi (t):** Numër i panjohur i përkrahësve të KF Shkupi.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykimit:** Në këtë incident që ndodhi gjatë një ndeshjeje sportive, motivi i paragjykimit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, dhe treguesit të paragjykimit janë:

1. *Dallimi në përkatësi etnike* - përkrahësit e KF Shkupi janë shqiptarë, ndërsa lojtarët e KF Vardar janë kryesisht maqedonas;
2. *Koha* - incidenti ka ndodhur pas një ndeshjeje futbolli midis klubeve me përkrahësit/tifozët e të cilëve kanë përkatësi të ndryshme etnike, pas një ndryshimi në praninë e pakicave në zonë (tifoze shqiptarë në lagje të populluar kryesisht me maqedonas);
3. *Natyra e dhunës* - incidenti është kryer në vend publik;
4. Mungesa e motiveve të tjera.

**Statusi i rastit:** janë ngritur fletëparaqitje për kundërvajtje.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se kanë dorëzuar fletëparaqitje për kundërvajtje kundër dy të dyshuarve dhe kundër personit juridik përgjegjës për sigurinë gjatë lojës.

**Ndikimi mbi viktimën dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në vend dhe sigurinë e njerëzve të pranishëm në ndeshjet sportive.

## 11. Emigrantët janë sulmuar dhe plaçkitur, një prej tyre i plagosur (e verifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Pesë persona të veshur me uniforma kamuflazhi dhe maska ushtarake sulmuan dhe plaçkitën një grup prej tetëmbëdhjetë emigrantësh. Gjatë plaçkitjes, njëri nga sulmuesit përdori armë zjarri, duke plagosur njërin prej viktimave në këmbë. Viktimat, megjithatë, arritën të mbizotërojnë sulmuesin me armë zjarri, ia morën armën, dhe e raportuan rastin në polici.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 16 prill, ora 01:00, fshati Studeniçan, pranë Shkupit.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike Kajgana.

**Viktimat e përfshira:** Tetëmbëdhjetë emigrantë (kombësia nuk specifikohet) janë sulmuar dhe plaçkitur, një shtetas sirian është plagosur me armë zjarri.

**Lloji i krimit (s):** Plaçkitje (neni 237 i kodit penal), Lëndime të rënda trupore (neni 131 i kodit penal), Dhunë (neni 386 i kodit penal).

**Kryerësi(t):** Grup i panjohur prej pesë autorësh.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykimit:** Në këtë incident, motivi i paragjykimit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, dhe treguesit e paragjykimit janë:

1. *Dallimi në përkatësisë etnike* - përkatësia etnike e autorëve dhe e viktimave dallojnë; viktima është anëtar i një grupi (emigrant sirian) që është i paktë në numër në krahasim me grupin tjetër (të popullsisë maqedonase), në zonën ku ndodhi incidenti;

**Status i rastit:** Është ngritur kallëzim penal.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se kanë ngritur kallëzim penal për aktin e plaçkitjes dhe prodhimin e paautorizuar, mbajtjen, ndërmjetësimin ose tregtinë me armë ose materiale shpërthyesë. Numri i të dyshuarve nuk është i specifikuar.

**Ndikimi mbi viktimën dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve që hyjnë dhe kalojnë përmes vendit.

## 12.Edhe një automjet i një aktivisti të LSDM-së është djegur në Manastir (verifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Automjetit të një anëtarë të njohur dhe aktivisti të LSDM-së iu vu zjarri.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 16 prill, ora 02:30. Rruga Mihajlo Andonovski, Manastir.

**Burimi i informacionit:** Televizioni kombëtar Telma.

**Viktima(t) e përfshira:** Përveç dëmeve materiale, nuk ka pasur viktima të drejtpërdrejta në këtë incident.

**Lloji i krimit (s):** Dëmtimi i pronës së të tjerëve (neni 243 i kodit penal), Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm (neni 288 i kodit penal).

**Kryerësit:** Të panjohur.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të paragjyimit: Në këtë incident, motivi i urrejtjes është përkatësia politike dhe bindja politike, dhe treguesi i urrejtjes është:

1. *Perceptimi i viktimës* - sipas një deklarate të dhënë për mediat, viktima e percepton këtë incident si të motivuar nga paragjykimet;

2. *Natyra e dhunës* - incidenti është kryer në vend publik;

3. *Mungesa e motiveve të tjera*.

**Statusi i rastit:** Nën hetim.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se po ndërmerren masat e nevojshme për sqarimin e incidentit.

**Ndikimi mbi viktimën dhe bashkësinë:** Ky lloj i incidentesh vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në vend.

## 13.Kryetari i degës së rinisë së VMRO DPMNE-së në Komunën Qendër është rrëmbyer dhe rrahur (e paverifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Tre autorët duke udhëtuar në një automjet sulmuan pesë të rinj (midis të cilëve ishte edhe kryetari i degës së të rinjve të VMRO-DPMNE-së në Komunën Qendër). Pasi që katër prej tyre arritën të ikin, sulmuesit kapën kryetarin e degës së të rinjve, vazhduan ta rrahin, e detyruan të hyjë në automjet dhe e çuan atë për një periudhë të shkurtër rreth lagjes dhe e fotografuan atë në automjet.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 18 prill, ora 02:00. Komuna Qendër, Shkup.

**Burimi i informacionit:** media Nacionale elektronike Kurir.

**Viktima(t) e përfshira:** Pesë persona të rinj u sulmuan, njëri prej të cilëve u rrah më rëndë dhe në mënyrë të paligjshme u privua nga liria e tij për një periudhë të shkurtër kohe.

**Lloji i krimit (eve):** Dhunë (neni 386 i kodit penal), Privim i paligjshëm nga liria (neni 140 i kodit penal).

**Kryerësi(t):** Tre meshkuj.

Përshkrim i shkurtër i incidentit me indikatorë të paragjyimit: Në këtë incident, motivi i paragjyimit është përkatësia politike dhe bindjet politike, dhe indikatorët e paragjyimit janë:

1. *Perceptimi i dëshmitari* - disa media kanë raportuar se sulmuesit janë anëtarë dhe aktivistë të LSDM-së;

2. *Natyra e dhunës* - incidenti është kryer në vend publik, viktima është fotografuar gjatë incidentit;

3. *Mungesa e motiveve të tjera*.

**Statusi i rastit:** Janë ngritur akuza për kundërvajtje.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** MPB iu përgjigj kërkesës për informacion publik të dërguar nga Komiteti se janë ngritur tri fletëparaqitje për kundërvajtje për aktin e sulmit fizik. Edhe pse disa media raportojnë se MPB do të nisë kallëzim penal edhe për privimin e lirisë, deri në momentin e shkrimit të këtij raporti, Komiteti nuk ka një informacion të tillë.

**Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë:** Ky lloj incidentesh vë në pikëpyetje stabilitetin e përgjithshëm politik në vend.

#### 14. Emigrantë janl sulmuar me thikë (e verifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Në oborrin e xhamisë, tre persona kanë sulmuar dhe plaçkitur një person të kombësisë afgane. Viktima ka pësuar dëmtime të rënda trupore ndërsa sulmuesit ia kanë marrë telefonin e tij dhe rreth 400 euro.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 15 maj ora 02:00, xhamia në fshatin Llojan, Kumanovë.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike Kumanovskimuabeti.

**Viktima e (s) përfshirë:** Një shtetas afgan.

**Lloji i krimit (s):** Grabitje (neni 237 i kodit penal), dëmtime të rënda trupore (neni 131 i kodit penal), Dhunë (neni 386 i kodit penal).

**Kryerësit:** Grup prej tre autorësh.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të urrejtjes:** Në këtë incident, motiv i paragjykitimit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, dhe treguesit e paragjykitimit janë:

1. *Dallimi në përkatësinë etnike* - përkatësia etnike e autorëve dhe viktimës dallojnë; viktima është anëtar i grupit (emigrant afgan) i cili ka është më i vogël se grupi tjetër (i popullsisë maqedonase), në zonën ku ka ndodhur incidenti;

**Status i rastit:** Është ngritur kallëzim penal.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se kanë paraqitur kallëzim penal kundër tre të dyshuarve për veprën penale Grabitje.

**Ndikimi mbi viktimën (at) dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve që hyjnë dhe kalojnë përmes vendit.

#### 15. Dy shtetas sirianë janë plaçkitur në Parkun e qytetit në Kumanovë (e verifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Pesë persona të panjohur kanë sulmuar dhe grabitur dy shtetas sirianë. Sulmuesit morën një orë dore dhe 500 euro.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 15 maj 19:00 orë, Parku i qytetit, Kumanovë.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike A1on.

Viktimat e përfshira: Dy shtetas sirianë.

**Lloji i krimeve:** Grabitje (neni 237 i kodit penal), Dhunë (neni 386 i kodit penal).

**Kryerësit:** Grup i panjohur prej pesë autorësh.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykitimit:** Në këtë incident, motiv i paragjykitimit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, dhe treguesit e paragjykitimit janë:

1. *Dallimi në përkatësinë etnike* - përkatësia etnike e autorëve dhe viktimës dallojnë; viktima është anëtar i grupit (emigrant sirian) që është i paktë në numër në krahasim me anëtarët e grupit tjetër më të madh (të popullsisë maqedonase), në zonën ku ndodhi incidenti;

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është i fundit i një trendi në rritje të plaçkitjeve dhe sulmeve ndaj emigrantëve.

**Status i rastit:** Është ngritur kallëzim penale.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se kanë paraqitur kallëzim penal kundër pesë të dyshuarve për veprën penale Grabitje.

**Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve që hyjnë dhe kalojnë përmes vendit.

## 16. Gjumnazist - maturant u sulmua për shkak të valëvitjes së flamurit kombëtar (e verifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Disa autorë kanë sulmuar një të diplomuar të shkollës së mesme dhe mikun e tij, për shkak se ata kanë vendosur një flamur kombëtar në sallën e hotelit Kontinental, ku nxënësi ka festuar diplomimin e tij. Pas krenimit, babai i të diplomuarit erdhi për ta marrë djalin e tij për në shtëpi me veturë. Në rrugë, automjeti i tyre u ndoq së pari nga një automjet Mercedes. Shpejt pas kësaj, ata u ndaluan me forcë nga një automjet Audi. Nga Audi, dolën disa njerëz me shkopi druri dhe duke kërcënuar për të përdorur armë zjarri, kanë dëmtuar automjetin. Gjatë sulmit, tre nga viktimat kanë fituar lëndime të lehta nga qelqi i shpartalluar.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 25 maj 22:30 ora, Shkup.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike mkd-news.

**Viktimat e përfshira e përfshira:** katër persona gjithsej - dy prej tyre të sulmuar në hotelin Kontinental, dhe dy të tjerë kur ishin duke ngarë makinën e njërit prej viktimave.

**Lloji i krimit (s):** Dhunë (neni 386 i kodit penal), lëndime trupore (neni 130 i kodit penal), dëmtimi i pronës së tjetrit (neni 243 i kodit penal).

**Kryerësit:** Grupi i panjohur të rinjsh.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykit:** Në këtë incident, motiv i paragjykit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, ndërsa treguesit e paragjykit janë:

1. *Dallimi i supozuar në përkatësinë etnike* - incidenti ka ndodhur në një zonë të populluar nga njerëz me përbërje të përzier etnike;
2. *Dallimi supozohet në përkatësinë etnike* - viktimat ishin duke promovuar kombësinë e tyre (vendosje e flamurit) në kohën e incidentit;
3. *Natyra e dhunës* - incidenti është kryer në vend publik;
4. *Mungesa e motiveve të tjera.*

**Statusi i rastit:** Janë ngritur fletparaqitje për kundërvajtje dhe kallëzime penale.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka deklaruar se janë ngritur fletëparaqitje për kundërvajtje kundër dy personave për sulm para hotelit, kurse janë parashtruar kallëzime penale kundër tre personave për veprën penale e Dhunës për incidentin e fundit.

**Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në vend.

## 17. Emigrantë sirianë janë sulmuar dhe plaçkitur në afërsi të Gjevgjeli (e verifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Pesë shtetas sirianë, pas kalimit të kufirit në mënyrë të paligjshme, u sulmuan nga shtatë ose tetë persona të panjohur në fshatin Smokvicë. Sulmuesit morën 1.000 euro dhe tre telefona celularë nga viktimat.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 28 maj, 01:30 ora, fshati Smokvicë, Gjevgjeli.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike Kajgana.

**Viktimat e përfshira:** Pesë shtetas sirianë.

**Lloji i krimit:** Grabitje (neni 237 i kodit penal), Dhunë (neni 386 i kodit penal).

**Kryerësi (t):** Grup i panjohur prej 7-8 autorësh.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykit:** Në këtë incident, motivi paragjykit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, ndërsa treguesit e paragjykit janë:

1. *Dallimi në përkatësinë etnike* përkatësia etnike e kryerësve dhe viktimave ndryshon; viktimat janë anëtarë të një grupi (emigrant sirian) që është i paktë në numër në krahasim me anëtarët e një grupi tjetër të madh (të popullsisë maqedonase), në zonën ku ndodhi incidenti;

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është i fundit i një trendi në rritje të plaçkitjeve dhe sulmeve ndaj emigrantëve.

**Status i rastit:** Është ngritur kallëzim penal.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se ka ngritur kallëzim penal penale kundër shtatë të dyshuarve për veprën penale të Grabitjes.

**Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve që hyjnë dhe kalojnë përmes vendit.

## 18. Emigrantë të rrëmbyer dhe të mbajtur në Vaksincë (e verifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Në fshatin Vaksincë, është zbuluar një shtëpi, ku janë kapur dhe mbajtur emigrantët. Një numër i madh i njerëzve janë mbajtur në disa dhoma të vogla, por të mbushura përplot. Ata nuk ishin në gjendje për të shpëtuar, për shkak të njerëzve të armatosur që ishin duke siguruar objektin. Doli një video-xhirim, ku mund të vëreheshin se si “rojet” rrihnin emigrantët. Emigrantët ishin të detyruar të paguajnë për lirinë e tyre, pas së cilës ata u lejuan të vazhdojnë në Serbi në këmbë.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** periudhë e pacaktuar, në maj dhe qershor, fshati Vaksincë pranë Kumanovës.

**Burimi i informacionit:** Channel 4 media, Britania e Madhe.

**Viktimat e përfshira:** Numër i madh i emigrantëve.

**Lloji i krimeve:** Rrëmbim (neni 141 i kodit penal), Dhunë (neni 386 i kodit penal), Lëndime trupore (neni 130 i kodit penal).

**Kryerësit:** Grup i panjohur i madh i autorëve.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykit:** Në këtë incident, motiv i paragjykit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, ndërsa tregues të paragjykit janë:

1. *Dallim në përkatësinë etnike* - përkatësia etnike e kriminelëve dhe viktimave ndryshon; viktimat janë anëtarë të një grupi (emigrantë Kryerësit të huaj) që është i paktë në numër në krahasim me anëtarët e një grupi tjetër më të madh (të popullsisë maqedonase dhe shqiptare), në zonën ku ka ndodhur incidenti;

2. *Model i incidenteve të mëparshme* - ky incident është i fundit i një trendi në rritje të dhunës me motiv paragjykim kundër emigrantëve.

**Status i rastit:** Është ngritur kallëzim penal.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se kanë paraqitur kallëzime penale kundër katër të dyshuarve për aktin e kontrabandës me migrantët (neni 418-a i kodit penal).

**Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje sigurinë e emigrantëve që hyjnë dhe kalojnë përmes vendit.

## 19. Incident në ndeshjen e basketbollit mes ekipeve të të rinjve të Feni Industri dhe Shkupi (e verifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Pas gjysmës së parë të lojës, kur arbitri i dytë dha një faull teknik, të gjithë lojtarët dhe trajneri asistent i KB Shkupi hynë në fushë dhe deshën ta sulmojnë arbitrin, Delegati i Federatës së Basketbollit ndërpreu lojën, dhe kërkoi nga përfaqësuesit e policisë që në mënyrë të sigurtë të përcjellin arbitrat në dhomat e zhveshjes. Gjatë incidentit, lojtarët e Shkupi ishin duke hedhur shishe plastike në drejtim të audiencës. Pas incidentit, të gjithë anëtarët e KB Shkupi janë shoqëruar për në Shkup. Megjithatë, një tjetër media raporton se policia, gjatë ndërhyrjes ka plagosur dy lojtarë basketbolli dhe një djalë tjetër shqiptar. Sipas këtij mediumi, mbi 200 tifozët e KB Feni kanë shprehur zemërimin e tyre përmes urrejtjes nacionaliste dhe racore.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 9 qershor, ora 17:00, Kavadar.

**Burimi i informacionit:** Media elektronike Sport365 dhe Zhurnal.

**Viktimat e përfshira:** Një arbitër, viktima të mundshme midis lojtarëve të Shkupi dhe tifozëve të tyre (me përdorimin e forcës së Policisë).

**Lloji i krimeve:** Dhunë (neni 386 i kodit penal).

**Kryerësit:** Numër i panjohur i përkrahësve të KB Shkupi.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykimit:** Në këtë incident që ndodhi gjatë një ndeshjeje sportive, motiv i paragjykimit është origjina etnike, shtetësia apo gjuha, ndërsa treguesit e paragjykimit janë:

1. *Dallimi në përkatësinë etnike* - tifozët dhe shumica e lojtarëve të KB Shkupi janë shqiptarë, ndërsa lojtarët dhe tifozët e KB Feni Industri janë kryesisht maqedonas;
2. *Koha* - incidenti ka ndodhur pas një ndeshjeje të basketbollit midis klubeve me përkrahësit / tifozët me përkatësi të ndryshme etnike, pas një ndryshimi në praninë e pakicës në zonë (lojtarë dhe tifoz shqiptarë në lagje të populluar kryesisht nga maqedonasit);
3. *Natyra e dhunës* - incidenti është kryer në vend publik;
4. *Mungesa e motiveve të tjera.*

**Statusi i rastit:** Në hetim.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se SP GJ Kavadarci ka kontaktuar me SP GJ Bit Pazar dhe ka kërkuar që të thërrasë autorët për të lëshuar fletëparaqitje për kundërvajtje. Megjithatë, nuk ka asnjë informacion nëse të dyshuarit janë gjetur dhe nëse është dërguar akuza kundërvajtëse.

**Ndikimi mbi viktimat dhe bashkësinë:** Ky incident vë në pikëpyetje bashkëjetesën etnike midis dy bashkësive më të mëdha në vend dhe sigurinë e njerëzve të pranishëm në ndeshjet sportive.

## 20. Është vandalizuar automobili i një nënkryetares të LSDM-së në Shkup (e paverifikuar)

**Çfarë ka ndodhur:** Ndërsa nënkryetarja LSDM-së ishte duke marrë pjesë në një debat, një (disa) kryerës i panjohur ka vandalizuar automjetin e saj, duke prerë gomat me një objekt të mprehtë. Ajo raportoi incidentin në polici.

**Data, koha dhe vendi i incidentit:** 22 qershor, 14: 00, komuna Qendër, Shkup.

**Burimi i informacionit:** Ueb portali Fokus.

**Viktimat e përfshira:** Përveç dëmeve materiale, nuk ka pasur viktima të drejtpërdrejta në këtë incident.

**Lloji i krimeve:** Dëmtimi i pronës së tjetrit (neni 243 i kodit penal).

**Kryerësit:** Të panjohur.

**Përshkrim i shkurtër i incidentit me tregues të paragjykimit:** Në këtë incident, motiv i paragjykimit është përkatësia politike dhe bindja politike, ndërsa treguesi i paragjykimit është:

1. *Perceptimi i viktimës* - sipas një deklaratë të dhënë për mediat, viktima e percepton këtë incident si motiv me paragjykim;
2. *Koha* - incidenti ka ndodhur ndërkohë që viktima ishte duke promovuar grupin me të cilin ajo është e lidhur politikisht (ka marrë pjesë në një debat të drejtpërsëdrejti);
3. *Natyra e dhunës* - incidenti është kryer në vend publik;
4. *Mungesa e motiveve të tjera.*

**Statusi i rastit:** Nën hetim.

**Përgjigja e autoriteteve lokale:** Duke iu përgjigjur kërkesës për informacion me karakter publik, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjigjur se po ndërmerren masat e nevojshme për sqarimin e rastit.
